

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 8004  
E martë, 4 mars 2025  
Çmimi 0.50

## A pritet të përfundojë këtë vit gjykimi i madh në Hagë?



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)  
facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KTHESA E BEFTË E POLITIKËS AMERIKANE: 'KOSOVA TË BËHET MË E DËGJUESHME'




Përplasja diplomatike në Shtëpinë e Bardhë, në mes të presidentit të ShBA-së, Donald Trump, dhe presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky, shtangu aleatët e tyre gjatë. Udhëheqësit e BE-së nxituan ta rikonfirmonin

mbështetjen për Kievin, duke u zotuar se do të punojnë së bashku drejt paqes së qëndrueshme. Transformimi i shpejtë i politikës amerikane vjen pas viteve të izolimit të Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës dhe,

pashmangshëm, shtron pyetjen: a mund të përballet Kosova me fat të ngjashëm në mosmarrëveshjen e saj me Serbinë? Disa analistë thonë jo por, në të njëjtën kohë, sugjerojnë që Kosova të bëhet "më e dëgjueshme"

## NUMËRIMI I VOTAVE ME POSTË DREJT FUNDIT, PRIN LV-ja



## HAJNAT E DONIKËS



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

## AKTUALE



### BRITANIA THOTË SE "S'KA MARRËVESHJE" ME FRANCËN PËR PROPOZIMIN E ARMËPUSHIMIT NË UKRAINË

### MBI 200 MIJË EURO VLERA E PASURISË SË KONFISKUAR NË TRE MUJT E FUNDIT TË VITIT TË KALUAR

### MUNGESA E BARNAVE ESENCIALE, OFK: VENDIMI PËR ÇMIMIN E BARNAVE KA SJELLË KRIZË NË SEKTORIN SHËNDETËSOR

### HAPET KONKURSI PËR BURSAT E VITIT AKADEMIK 2024/'25

## EKONOMI



### RRETH 8 MILIONË EURO PËR 12 KOMUNA PËRFITUESE

### NGA MUAJI PRILL AGJENCIA PËR ZHVILLIMIN E BUJQËSISË BËHET ME HAPËSIRA TË REJA PUNE

## SPORT



### KURTI: MEDALJA E DONJETA SADIKUT ËSHTË E VEÇANTË PËR KOSOVËN

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Mobi: +377 44 501289

**PRINCESHA** GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Raportuesi i PE-së për Serbinë fajëson Vuçiçin për mosrealizimin e takimeve

STRASBURG, 3 MARS - Raportuesi i përhershëm i Parlamentit Evropian për Serbinë, Tonino Picula, pas vizitës së tij në Beograd, gjatë së cilës nuk u takua me zyrtarët më të lartë shtetërorë, tha se presidenti i Serbisë, Aleksandar Vuçiç, kishte planifikuar një gjë të tillë. "Vendimin që kontaktet e drejtpërdrejta me mua, në emër të pushtetit, të reduktohen ekskluzivisht në bisedime në Kuvendin Popullor dhe në Ministrinë për Integritet Evropianë e mori, natyrisht, presidenti Vuçiç, pasi vetëm ai vendos për lëvizje të tilla", konfirmoi Picula për Radio Evropa e Lirë.

Picula shkoi në Beograd pasi që më 20 shkurt, në Komisionin për Politikë të Jashtme të Parlamentit Evropian, u paraqit draft-raporti i cili u përball me kritika nga autoritetet serbe.

Takimin me raportuesin për Serbinë e refuzoi Vuçiç, i cili e quajti Piculën "gënjeshtar". Përveç Vuçiçit, takimin e refuzoi

edhe kreu i grupit parlamentar "Aleksandar Vuçiç - Serbia nuk duhet të ndalet" në Kuvendin e Serbisë, Milenko Jovanov.

Picula pretendon se qëndrimi negativ i qeverisë ndaj draft-raportit për situatën në vend ishte promovuar që para mbërritjes së tij. "Nga ana tjetër, nuk do të ishte e drejtë të reduktohej kuptimi dhe rezultatet e qëndrimit tim në Serbi vetëm në takimet që nuk pata me presidentin e shtetit, kryeministrin në detyrë dhe ministrin e Punëve të Jashtme", tha Tonino Picula.

Gjatë qëndrimit të tij në Serbi, ndodhi gjithashtu një aksion policor në ambientet e disa organizatave joqeveritare në Beograd.

Picula konfirmon se edhe ky element, së bashku me të gjitha përshtypjet nga vizita, do të përfshihen në vijimin e punës për raportin mbi gjendjen në Serbi. Ai vlerësoi se misioni katërditor në kapacitetin e raportuesit të përhershëm të



Parlamentit Evropian për Serbinë ka treguar se nuk do të jetë e mundur të kapërcehen lehtësisht dallimet në vlerësimet për situatën në vend mes tij dhe përfaqësuesve të pushtetit, me të cilët nuk pati mundësinë të bisedojë. "Ngjarjet më të rëndësishme në Serbi prej muajsh janë protestat masive të udhëhequra nga studentët, të cilët po bllokojnë institucionet arsimore. Protestat janë përhapur pothuajse në të gjithë

vendin. Sipas mendimit tim, bëhet fjalë për një presion të përgjithshëm shoqëror mbi politikën, me qëllim çlirim të institucioneve të shtetit nga gjithçka që i ka bllokuar për vite me radhë", thekson Picula. Sipas tij, zhvillimet e ardhshme do të varen nga marrëdhëniet mes katër faktorëve që ai i konsideron më me ndikim: pushtetit, i cili nuk po arrin t'i shpërndajë protestat; opozitës institucionale, e cila nuk i drejton

zhvillimet; komunitetit ndërkombëtar, që kryesisht po mban distancë; dhe studentëve, të cilët kanë një bazë të gjerë legjitimiteti, por ende nuk e kanë zgjeruar listën e kërkesave përtej atyre fillestare.

Studentët, të cilët nga fundi i nëntorit kanë bllokuar më shumë se 60 fakultete në të gjithë vendin, kërkojnë përgjegjësi penale dhe politike për tragjedinë në Novi Sad, ku më 1 nëntor 2024 u rrëzua çatia e Stacionit Hekurudhor, duke shkaktuar vdekjen e 15 personave.

Studentët kërkojnë gjithashtu ndjekjen penale të përgjegjësve për sulmet ndaj tyre dhe qytetarëve të tjerë gjatë protestave.

Pushteti, i udhëhequr nga presidenti Vuçiç, pretendon se në Serbi po tentohet një "revolucion me ngjyra" dhe këmbëngul se kërkesat e studentëve janë plotësuar. Studentët dhe opinioni akademik i hedhin poshtë këto pretendime.

## Britania thotë se 's'ka marrëveshje' me Francën për propozimin e armëpushimit në Ukrainë

LONDËR, 3 MARS - Franca dhe Britania e Madhe nuk kanë rënë dakord për një plan armëpushimi të pjesshëm për Ukrainën, tha një ministër britanik të hënën, raporton agjencia e lajmeve AFP, pasi presidenti francez, Emmanuel Macron, deklaroi se një propozim i tillë ishte bërë nga dy vendet.

Macroni i tha gazetës franceze Le Figaro të dielën se Londra dhe Parisi po propozojnë një armëpushim njëmuajor në Ukrainë "në ajër, në det dhe për infrastrukturën energjetike".

Macroni tha se ky armëpushim fillimisht nuk do të përfshinte luftimet tokësore. "Asnjë marrëveshje nuk është arritur mbi atë se si do të duket një armëpushim", tha ministri



britanik i Forcave të Armatosura, Luke Pollard, për Times Radio. "Por, ne po punojmë së bashku me Francën dhe aleatët tanë evropianë për të shqyrtuar se cili është rrugëtimi drejt krijimit të një paqeje të

qëndrueshme në Ukrainë", shtoi ai.

Një zyrtar i qeverisë britanike gjithashtu minimizoi çdo marrëveshje të mundshme. Duke folur në kushte anonimiteti, ai tha per Reuters se "ka opsione të ndryshme

mbi tryezë, të cilat janë subjekt i diskutimeve të mëtejshme me ShBA-në dhe partnerët evropianë, por një armëpushim njëmuajor nuk është rënë dakord".

Komentet e Macronit erdhën pasi kryeministri britanik, Keir Starmer, thirri bisedime urgjente për Ukrainën me liderët evropianë, kreun e NATO-s, Mark Rutte, dhe Kanadanë, në qendër të Londrës të dielën. "Ashtu siç tha kryeministri në konferencën e tij për shtyp, ne kemi nevojë dhe dëshirojmë të përparojmë me shpejtësi dhe jemi të kënaqur që samiti ka mundësuar që diskutimet të ecin përpara. Këto diskutime do të vazhdojnë me ritëm të shpejtë", tha një zëdhënës i

Downing Street.

Takimi përfshiu dhjetëra liderë evropianë, përfshirë

presidentin ukrainas. Të pranishëm në takimin në Londër ishin edhe kryeministri kanadez, Justin Trudeau, ministri i jashtëm turk, Hakan Fidan, sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, dhe presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa.

Në konferencë nuk mori pjesë ndonjë përfaqësues i ShBA-së. Vizita e Zelenskyt në Uashington më 28 shkurt u ndërpre para kohe pas përplasjes me presidentin Donald Trump dhe nënpresidentin amerikan, JD Vance.

## Një person i vdekur në Manhajm të Gjermanisë pas përplasjes së makinës në turmë

MANHAJM, 3 MARS - Një person ka vdekur edhe disa të tjerë janë lënduar si pasojë e një incidenti në Manhajm të Gjermanisë, pasi një person e ka përplasur makinën në një turmë njerëzish.

Zyrtarët kanë thënë se është e paqartë nëse në sulm janë të përfshirë persona tjerë, ndërsa policia u ka bërë thirrje banorëve të zonës që të qëndrojnë në shtëpi.

Incidenti ka ndodhur teksa turma njerëzish janë mbledhur në landet

perëndimore të Gjermanisë, për të mbajtur paradat që shënojnë sezonin e karnevaleve.

Mediat lokale kanë raportuar se një makinë e zezë është nisur me shpejtësi të madhe drejt një grupi njerëzish, të cilët ishin nisur prej sheshit Paradeplatz drejt një zone historike të qytetit.

Siguria është bërë shqetësuese në Gjermani, pas një morie sulmesh që kanë ndodhur në javët e fundit, përfshirë sulmet

vdekjeprurëse me makina drejt turmave në dhjetor në Magdeburg dhe në Muni një muaj më parë, ashtu sikurse sulmi me thikë në Manhajm, në maj të vitit 2024.

Policia është në gjendje alarmi në periudhën e mbajtjes së paradave të këtij viti, pas në disa llogari në rrjetet sociale, të lidhura me grupin ekstremist Shteti Islamik, janë bërë thirrje për sulme në organizimet në Këln dhe Nuremberg.



# NUMËRIMI I VOTAVE ME POSTË DREJT FUNDIT, PRIN LV-ja

EPOKA  
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 3 MARS - Në orët e para të së hënës Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka përditësuar rezultatet e votave me postë të numëruara deri më tani, të vlefshme për zgjedhjet e rregullta parlamentare që u mbajtën më 9 shkurt.

Me mbi 66 për qind të vendvotimeve të procesuara, Lëvizja Vetëvendosje prin me 52.72 për qind, e ndjekur nga Lidhja Demokratike e Kosovës me 29.8 për qind.

Sipas rezultateve të publikuara online nga autoritetet zgjedhore, në vendin e tretë gjendet Partia Demokratike e Kosovës me 7.98 për qind, ndërsa vendin e katërt e zë koalicioni në mes të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe Nismës Socialdemokrate, me 3.32 për qind.

Numërimi i votave me postë nisi më 28 shkurt dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka thënë se ka aprovuar më shumë se 63 000 pako me fletëvotime.

Për votimet e 9 shkurtit, përveç votimit me postë, qytetarët jashtë vendit për herë të parë kanë mundur të votojnë edhe fizikisht në disa përfaqësi diplomatike.

Numërimi i votave nga përfaqësitë diplomatike ka përfunduar dhe, sipas KQZ-së, LV-ja mori më së shumti vota, përkatësisht 12 261 vota apo 80.71 për qind.

Zëdhënësi i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Valmir Elezi, ka thënë se deri të martën do ta përmbyllin numërimin e të gjitha fletëvotimeve me postë. Ai në


një deklaratë për medie ka thënë se pastaj do të fillojnë numërimi i fletëvotimeve me kusht, i cili është zhvilluar në 56 vendvotime. "Brenda një kohe të shpejtë deri në ditën e martë do të arrijmë ta përmbyllim numërimin e të gjitha fletëvotimeve me postë dhe pas kësaj do ta fillojmë numërimin e fletëvotimeve me kusht, i cili është zhvilluar në 56 vendvotime, si dhe pastaj numërimin të votave të personave me nevoja të veçanta. Pasi t'i përmbyllim të gjitha këto procese dhe pasi ta marrim konfirmimin nga ana e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia dhe Gjykatës Supreme se nuk ka ndonjë çështje e cila është duke u shqyrtuar në këto institucione, atëherë KQZ-ja do të mund ta shpallë rezultatin përfundimtar për subjektet politike dhe kandidatët për deputetë", ka thënë Elezi.

Sipas rezultateve preliminare të votimit të rregullt, Lëvizja Vetëvendosje është e para me 40.80 për qind të votave të fituara, pasuar nga Partia Demokratike e Kosovës me 22.05 për qind.

E treta ka dalë Lidhja Demokratike e Kosovës me 17.64 për qind të votave, pasuar nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës me 7.46 për qind të votave të fituara. Këto shifra tregojnë se asnjëra parti nuk ka mjaftueshëm vota për ta formuar shumicën në Kuvendin me 120 ulëse të Kosovës.

Nga partitë e komunitetit serb, më së shumti vota ka marrë Lista Serbe, përkatësisht 4.62 për qind.

Analisti politik Shenoll Muharremi ka thënë se me



këtë trend të votave, Lëvizja Vetëvendosje merr 48 deputetë në Kuvendin e Kosovës. "Sipas rezultateve aktuale (100 % Kosovë + 70 % diasporë) me votat e numëruara (A) aktualisht kemi mandatet si në vijim: LV 48; PDK 24; LDK 20; Pakicat 20; AAK-Nisma 8. Me këtë trend (B), nëse vazhdojnë këto rezultatet dhe nuk ndryshon diçka kur numërohen 100 % të diasporës dhe përfshihen votat me kusht dhe ato të veçanta, kemi mandatet si në vijim: LV 48; PDK 23; LDK 21; Pakicat 20; AAK-Nisma 8", ka thënë Muharremi.

Ndërkaq Astrit Gashi, një nga analistët dhe njohësit e sistemit zgjedhor, ka thënë se rezultatet përfundimtare të

votave me postë tregojnë një goditje të rëndë për PDK-në. "Procesi i numërimin të votave po shkon drejt fundit dhe, sipas trendit aktual, pasqyra përfundimtare e votave nga diaspora do të jetë: Lëvizja Vetëvendosje - mbi 30 000 vota. LDK-ja mbi 17 000 vota. PDK-ja mbi 4 500 vota. AAK-Nisma afër 1 900 vota. Një ndër befasishtë më të mëdha të këtij procesi është rënia dramatike e Partisë Demokratike të Kosovës në votat nga diaspora në numër një shifror 8%. Asnjë kandidat i saj nuk ka arritur të sigurojë mbështetje të konsiderueshme, me përjashtim të Xhakës, i cili mund të marrë rreth 2,000 vota të cilat si ndihmojnë

asgjë! Të gjithë kandidatët e tjerë të PDK-së nga diaspora nuk pritet të arrijnë as 500 vota, duke dëshmuar një krizë të thellë të partisë në këtë segment të elektoratit", ka shkruar Gashi në "Facebook". Ai ka thënë se pas këtij debakli elektoral të PDK-së, dikush duhet të marrë përgjegjësi. Disfata e PDK-së në këto zgjedhje nuk është thjesht një çështje numrash, por një pasqyrë e qartë e krizës së saj politike dhe mungesës së mbështetjes në segmentet kyçe të elektoratit, si diaspora dhe qytetet e mëdha. Pyetja kryesore që mbetet tani është: a do të ketë përgjegjësi politike dhe dorëheqje pas këtyre rezultateve?", ka thënë Gashi.

## Mbi 200 mijë euro vlera e pasurisë së konfiskuar në tre muajt e fundit të vitit të kaluar

PRISHTINË, 3 MARS - Në tre muajt e fundit të vitit të kaluar janë raportuar pasuri të konfiskuara në shumën mbi 200 mijë euro, ndërsa vlera e pasurive të sekuestruara për tetor - dhjetor është mbi 3.7 milionë në 51 raste. Kështu u tha të hënën në mbledhjen e Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Kryesuesi i Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik, Shqipdon Fazliu, ka shpalosur raportin tremujor tetor - dhjetor të vitit të kaluar. "Në tremujorin e fundit janë raportuar pasuri të konfiskuara në shumën prej 207 mijë eurosh, në shtatë raste, ndërsa vlera e sekuestrimeve për këtë tremujor e kap vlerën e mbi 3.7 milionë euro pasuri të sekuestruara apo në 51 raste të ndryshme. Kjo është një veçori pozitive, meqë ka pasur raste edhe me konfiskim edhe me sekuestrim. Një aspekt tjetër pozitiv për



tremujorin e fundit të vitit 2024 ka qenë vazhdimi i përgjigjeve pozitive në kërkesat për shitjen e

aseteve, ku në tremujorin e fundit janë paraqitur 28 kërkesa", tha ai.

Më tutje, Fazliu theksoi se nga ana e Prokurorisë Speciale janë paraqitur katër kërkesa për

shitje të aseteve. Megjithatë, theksoi se ka dështim të funksioneve prokuroriale meqë, sipas tij, ka prokurorë që nuk bëjnë kërkesa për shitje të aseteve. "Gjatë ditëve dhe javëve të kaluara kemi kërkuar nga ana e koordinatoreve lokalë të shtohet puna në paraqitjen e kërkesave të tilla, mirëpo nga përgjigjet që kemi pranuar shihet se ka prokurori dhe prokurorë që nuk kanë kthyer fare përgjigje në këtë çështje. Ne e kemi pajisur kryeprokurorin e shtetit dhe kryesuesin edhe me lista të posaçme të secilës prokurori, ku mund të shihen që ka prokurori dhe prokuror që me tepër se pesë apo gjashtë vjet kanë veturat e sekuestruara, mirëpo nuk kanë paraqitur kërkesa për shitje. Buxheti i shtetit po vazhdon që të dëmtohet në mënyrë të vazhdueshme me këtë çështje", shtoi ai.



# KTHESA E BEFTË E POLITIKËS AMERIKANE: "KOSOVA TË BËHET MË E DËGJUESHME"

Përplasja diplomatike në Shtëpinë e Bardhë, në mes të presidentit të ShBA-së, Donald Trump, dhe presidentit të Ukrainës, Volodymyr Zelensky, shtangu aleatët e tyre gjetkë. Udhëheqësit e BE-së nxituan ta rikonfirmojnë mbështetjen për Kievin, duke u zotuar se do të punojnë së bashku drejt paqes së qëndrueshme. Transformimi i shpejtë i politikës amerikane vjen pas viteve të izolimit të Rusisë për shkak të pushtimit të Ukrainës dhe, pashmangshëm, shtron pyetjen: a mund të përballet Kosova me fat të ngjashëm në mosmarrëveshjen e saj me Serbinë? Disa analistë thonë jo por, në të njëjtën kohë, sugjerojnë që Kosova të bëhet "më e dëgjueshme"

**PRISHTINË, 3 MARS** - Prej se Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, Shtetet e Bashkuara ishin mbështetëset kryesore të Kievit si në aspektin ushtarak, ashtu edhe në atë diplomatik. Por, sot, tre vjet më vonë, presidenti amerikan Donald Trump tingëllon më dashamirës ndaj Rusisë sesa Ukrainës. Gjatë një takimi në Shtëpinë e Bardhë, më 28 shkurt, Trumpi dhe zëvendësi i tij, JD Vance, patën një shkëmbim të tensionuar fjalësh me presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky, dhe e ndërprejnë disa herë njëri-tjetrin. Trumpi e akuzoi atë se po bën "bixhoz me jetën e miliona njerëzve" dhe "me Luftën e Tretë

Botërore" dhe i tha se "mund të kthehet kur të jetë gati për paqe". Ndryshimi i politikës amerikane nuk nisi këtu, por së paku dy javë më parë. "Sot dëgjova: Oh, ne nuk ishim të ftuar. Ju ishit atje për tre vjet. Ju nuk është dashur ta nisni kurrë. Keni mundur të bëni marrëveshje", tha Trumpi më 18 shkurt. Me këto komente të papritura, ai u duk se fajësoi Ukrainën për pushtimin rus dhe sugjeroi se ky vend mund të kishte "bërë marrëveshje" për ta shmangur luftën. Ukraina, megjithatë, u pushtua nga fqinji i saj në shkurt të vitit 2022 dhe konflikti që vazhdon, u bë më vdekjeprurës në Evropë që nga Lufta e Dytë Botërore. Trumpi, edhe në një shkrim në rrjetet sociale, përdori gjuhë të

ashpër për ta përshkruar presidentin e Ukrainës. Ai tha se Zelensky "refuzon të mbajë zgjedhje" dhe e quajti "diktator". Sipas tij, presidenti ukrainas "duhet të veprojë shpejt", ose "do të mbetet pa shtet". Trumpi duket se po vepron për ta përmbushur premtimin e tij për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë sa më shpejt që të jetë e mundur. Ai, fillimisht, zhvilloi një telefonatë me presidentin rus Vladimir Putin, ndërsa pak ditë më vonë, më 18 shkurt, delegacionet amerikane dhe ruse u mblodhën në Arabinë Saudite për t'i filluar bisedimet për specifikat. Ky ishte kontakti i parë mes palëve prej se Rusia nisi pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës, më 24 shkurt 2022,

dhe një ndryshim i beftë i politikës amerikane. E gjitha la të habitur edhe Ukrainën, edhe aleatët tradicionalë të ShBA-së në Evropë, që, për momentin, janë të mënjanuar nga negociatat. Por, në të njëjtën kohë, ngriti pikëpyetje edhe për vendet e tjera që varen nga mbështetja e ShBA-së, përfshirë Kosovën. Me Serbinë që refuzon ta njohë pavarësinë e saj dhe me dialogun mes tyre të bllokuar prej vitesh, a mund të ndodhë që ShBA-ja, nën Trumpin, të ndjekë një qasje të ngjashme edhe ndaj çështjes së Kosovës? Në një letër që presidenti i ShBA-së i dërgoi presidentes së Kosovës, Vjosa Osmani, në 17-vjetorin e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt, ai u citua të ketë thënë se ShBA-ja "do të vazhdojë të punojë me Kosovën në forcimin e institucioneve demokratike dhe promovimin e rritjes ekonomike". Po ashtu, u zotua se lidhjet mes dy vendeve do të zgjerohen. Profesori në pension i marrëdhënieve ndërkombëtare, Alon Ben-Meir, thotë se në këtë mes administrata Trump, megjithatë, mund ta favorizojë Serbinë - qoftë për shkak të lidhjeve më të ngushta me

presidentin serb, Aleksandar Vuçiq, interesave biznesore që ka dhëndri i Trumpit, Jared Kushner, në Serbi, apo ndikimit që ka emisari i tij për misionet të posaçme, Richard Grenell, me kritikën e vazhdueshme që i bën Qeverisë së kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti. "Por, kjo nuk do të thotë se Trumpi do ta braktisë Kosovën", thotë Ben-Meir, sepse "ai e di se për ta ruajtur stabilitetin në Ballkan, duhet të vendosë një lloj ekuilibri". "Dhe, në rastin konkret, edhe BE-ja është e përfshirë direkt. Ajo ka trupa në Kosovë dhe ai nuk mund ta anashkalojë për këtë çështje", thotë profesori amerikan për programin Expose të Radios Evropa e Lirë. Richard Caplan, profesor i marrëdhënieve ndërkombëtare në Universitetin e Oxfordit, thotë se Kosova ka qenë historikisht nën presion nga palët e jashtme, por se ka pasur vend në tryezë. Sipas tij, vetë kosovarët mund të tërheqin paralele me ukrainasit, porse ShBA-ja ka interesa më të ulëta në mosmarrëveshjen Kosovë-Serbi dhe kjo "i zvogëlon gjasat që Trumpi ta braktisë Kosovën, ashtu siç ka bërë me Ukrainën". "Marrë parasysh se disa nga

# KURTI MIRËPRITI FITUESIT E ÇMIMEVE TË VULLNETARIZMIT TË VITIT

PRISHTINË, 3 MARS - Kryeministri Albin Kurti së bashku me zëvendësministren e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Daulina Osmani, mirëpritën të hënën fituesit e Çmimeve të Vullnetarizmit të Vitit, të cilat jepen nga organizata 'Toka' për ndryshimtarë që kanë dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për shoqërinë.

Çmimet e Vullnetarizmit të Vitit janë një nismë e organizatës 'Toka' - me mbështetjen e 50 hisedarëve nga komuniteti lokal dhe ndërkombëtar që për qëllim ka mirënjohjen, promovimin dhe zgjerimin e pjesëmarrjes në vullnetarizëm.

Nga 100 nominime, vitin e kaluar për kontribut të jashtëzakonshëm u shpërblyen 8 fitues dhe u ndanë 7 mirënjohje të veçanta në shtatë kategori të ndryshme.

Prej tyre, në këtë takim të

pranishëm ishin Gazmend Hasani, "Vullnetari më Guximtar i Vitit"; Dion Istrefi, "Vullnetari më Kreativ i Vitit"; Viola Maksuti, "Vullnetarja e Vitit"; Bujar Neziri, fitues i Çmimit "Ambasadori i Diasporës më Përkrahës i Vitit"; Donika Shahini-Lami, fituese e Çmimit "Figura Publike më Përkrahëse e Vitit"; dhe Liridona Sylja nga kompania Kutia, fituese e Çmimit "Biznesi më Përkrahës i Vitit", që po shoqërohet nga drejtoresha ekzekutive e organizatës 'Toka' dhe drejtuesja e Programit për Zhvillim në këtë organizatë, Fjolla Shaqiri.

Kryeministri Kurti i uroi mysafirët për çmimet dhe i përgëzoi për angazhimin e tyre të jashtëzakonshëm. Në takim u theksua rëndësia e përfshirjes në punë vullnetare, veçanërisht e të rinjve, në të njëjtën kohë edhe promovimi dhe



mirënjohja e punës vullnetare në komunitet dhe shoqëri.

Kryeministri Kurti e ka përkrahur fushatën e Çmimeve të Vullnetarizmit të Vitit 2024 me një video promovuese ku kishte bërë thirrje për nominim të qytetarëve dhe

subjekteve që janë angazhuar apo kanë përkrahur vullnetarizmin në vend.

Si një nga hisedarët e fushatës, Zyra e Kryeministrit, e përfaqësuar nga Mirlinda Lushtaku, Zyrtare e Lartë për Koordinim të Politikave në

Sekretariatit Koordinues Qeveritar, kishte marrë pjesë në vlerësimin e nominimeve. Ndërkaq në konferencën e shpalljes së fituesve më 5 dhjetor 2024 kishte marrë pjesë ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrulla Çeku.

## HAPET KONKURSI PËR BURSAT E VITIT AKADEMIK 2024/'25



PRISHTINË, 3 MARS - Universiteti i Prishtinës ka hapur konkurs për bursat studentore të vitit akademik 2024/'25 në nivelin bachelor të studimeve.

Konkursi për bursa është i hapur nga 3 deri më 17 mars 2025, në orën 15:30.

Të drejtë konkurrimi kanë studentët e rregullt të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës, të vitit të dytë e më lart, që nuk kanë ndonjë vit të përsëritur. Aplikuesit e bursave

gjithashtu duhet të kenë kryer provimet e parapara të vitit akademik 2023/'24 në afatin e shtatorit të po atij viti dhe të kenë notën mesatare 9.00.

Studentët e fakulteteve të Ndërtimtarisë, Arkitekturës, Inxhinierisë Mekanike, Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike dhe ata të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore nga departamentet e Matematikës dhe Fizikës, mund të aplikojnë

edhe me notë mesatare më të ulët, por ajo nuk duhet të jetë nën 8.00.

Universiteti i Prishtinës që sivjet festoi 55-vjetorin e themelimit, është institucioni më i madh, më i vjetër, më i suksesshëm në Kosovë dhe i rendituri më së larti në platformat prestigjioze ndërkombëtare nga të gjitha universitetet në gjuhën shqipe të hapësirave gjeografike ku jetojnë shqiptarët.

veprimet e Trumpit përshkruhen si transaksionale, ai mund të përpiqet të krijojë marrëdhënie me Kosovën dhe me Serbinë - të atilla që u përgjigjen më shumë interesave të ShBA-së, sesa interesave të komunitetit evropian apo të Ballkanit Perëndimor", thotë Caplan.

Gjatë mandatit të parë si president, në periudhën 2017-2021, Trumpi ishte dëshmitar i nënshkrimit të një marrëveshjeje në mes të Kosovës dhe Serbisë për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike.

Shumë pak prej këtij dokumenti u zbatua në terren, por Trumpi tha se është "krenar për dy udhëheqësit" - kryeministrin e atëhershëm të Kosovës, Avdullah Hoti, dhe presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq.

Sivjet, në letrën që i dërgoi presidentes së Kosovës me rastin e 17-vjetorit të pavarësisë, Trumpi nuk e përmendi dialogun për normalizimin e marrëdhënieve mes Prishtinës dhe Beogradit. Ngjashëm, nuk e përmendi as në letrën që i dërgoi presidentit të Serbisë, me rastin

e Ditës së Shtetësisë, po ashtu në shkurt. Në të dyja letrat, ai theksoi kryesisht rëndësinë e bashkëpunimit.

Pavarësisht kësaj, profesori Ben-Meir pret që Kosova të përballet me trysni të shtuar nga ShBA-ja, për t'i dhënë komunitetit serb më shumë autonomi - gjë në të cilën edhe Serbia këmbëngul me vite. Dështimi për ta bërë këtë, do të kishte pasojë, thotë Ben-Meir dhe numëron disa: "Shtetet e Bashkuara mund të vendosin sanksione, mund të mos e ndihmojnë Kosovën ekonomisht, mund t'i bëjnë presion BE-së që të mos e avancojë integrimin e Kosovës në komunitetin e saj".

"Pra, Shtetet e Bashkuara mund të bëjnë presion të konsiderueshëm, nëse duan. Kjo është arsyeja përse mendoj se nuk mund ta injoroni atë që do të ShBA-ja", thotë Ben-Meir. Ai shton se lidhjet e Vuçiqit me Rusinë mund t'i lejojnë atij të ndikojë edhe në politikën amerikane. Ndërsa, organizimi i një takimi të mundshëm mes Trumpit e Putinit në Beograd - që është përfolur edhe më herët - vetëm se do ta forconte më tej

pozicionin e Serbisë.

Për t'iu kundërvënë të gjitha këtyre, Ben-Meir thotë se Kosova duhet të tregojë fleksibilitet, pa e kompromentuar pavarësinë e saj. "Asociacioni i komunave me shumicë serbe duhet të formohet. Nëse nuk dëshironi shkëmbime territoriale, bëjeni Asociacionin dhe bashkëpunimi me Serbinë, sepse Serbia ka interes të madh në ato komuna, meqë janë të banuara me shumicë serbe. Ndaj, duhet treguar fleksibilitet në këtë drejtim", thotë Ben-Meir.

Profesori Caplan thotë se Trumpi është vetëm në muajin e dytë të mandatit dhe se politika e tij e jashtme është ende duke marrë formë. Por, paralajmëron se sjellja e tij me Ukrainën duhet të shërbejë si sinjal për qasjen ndaj konflikteve të tjera të pazgjidhura, dhe t'i mbajë udhëheqësit së paku vigjilentë. "Jam i sigurt se ukrainasit ndiejnë se janë shitur në shumë aspekte. Prandaj, janë të arsyeshme shqetësimet se Trumpi mund të bëjë kompromise mbi parimet, kur ato u shërbejnë interesave të tij të ngushta, interesave të ShBA-

së", thotë Caplan.

Qasja e tillë e dukshme i ka alarmuar tashmë aleatët tradicionalë të ShBA-së në Evropë. Kancelari i pritshëm gjerman, Friedrich Merz, tha se kontinenti duhet ta forcojë sigurinë e tij sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të "pavarësohet" nga ShBA-ja. Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se BE-ja do të vazhdojë të punojë me Ukrainën "për një paqe të drejtë dhe të qëndrueshme".

Por, ndryshe prej tyre, kundërshtarët historikë të ShBA-së tingëllojnë më dashamirësisht ndaj sjelljes dhe retorikës së Trumpit. "Nëse do të më kishte thënë vetëm tre muaj më parë se këto do të ishin fjalët e presidentit amerikan, do të kisha qeshur me të madhe", shkroi në X nënkryetari i Këshillit rus të Sigurisë, Dmitry Medvedev, duke komentuar deklaratën e Trumpit se "Zelensky është diktator". Ndërkohë që paralajmërohen takime të tjera mes ShBA-së dhe Rusisë për Ukrainën, analistët nuk presin që kontesti mes Kosovës dhe Serbisë të jetë lart

në agjendën e Trumpit - sidomos së shpejti.

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e cila ka rol udhëheqës në politikën e jashtme të vendit, ka thënë se synon ta forcojë bashkëpunimin me administratën Trump, sidomos në fushën e mbrojtjes dhe të investimeve strategjike.

Ngjashëm, edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, kur e ka uruar Trumpin për fitoren në zgjedhje, ka thënë se mezi pret të punojë me të, në dobi të përparimit dhe paqes. Radio Evropa e Lirë pyeti Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës në Kosovë për aktivitetet e saj lobuese në ShBA, por në përgjigjen që mori, thuhet se "kontratrat e lobimit, në përputhje me ligjet në fuqi, mbeten konfidenciale".

Analistët thonë se për të naviguar në këtë peizazh të pasigurt, duhen, padyshim, shkathtësi diplomatike. E, nëse historia është ndonjë udhërrëfyes, aleatët e vegjël shpesh duhet të përshtaten, ose të mësohen të jetojnë me vendimet që të tjerët i marrin për ta.

# HAJNAT E DONIKËS



Behxhet Sh. Shala - BAJGORA

**Nuk është shpërputhje por përputhje:** MPJD udhëhiqet nga një e paditur, injorante par excellence. Ajo, nga kjo ministri ka larguar çdo frymë apo përmbajtje kombëtare dhe brutalisht e ka dhunuar profesionalizmin duke e zëvendësuar me injorantë partiakë dhe mbetje e trashëgimisë politike jugosllave dhe serbe. Analizoni sot listën e ambasadorëve, konsujve, sekretarëve, atashëve ushtarakë dhe të sigurisë dhe personelit tjetër dhe lehtësisht do të bindeni për atë që e them dhe e shkruaj. MPJD e ka shndërruar në qendër të prostituimit diplomatik, pa asnjë rezultat gjatë mandatit katërvjeçar. Asnjë njohje, asnjë anëtarësim në çfarëdo institucioni ndërkombëtar përjashtuar këtu dështimin kapital dhe të turpshëm të anëtarësimit në Këshill të Evropës. Kosova dhe qytetarët e saj nuk kanë se si të turpërohen më shumë se që janë “përfaqësuar” në botë nga kjo injorante e pariciklueshme që para dite urren veten kurse gjatë 24 orëve urren UÇK-në, ish të burgosurit politikë, Bacë Adem Demaçin dhe të gjithë ata

që kanë sakrifikuar për liri. Merreni me mend po hajgarexhi dhe cinik është KM i Kosovës Albin Kurthi, e lavdëron injoranten në fjalë për punë të shkëlqyer. Askush nuk e ka dëmtuar dhe turpëruar Kosovën në rrafshin diplomatik se kjo mendermethënë ministre.

**Zgjedhjet e 9 shkurtit 2025:** Ministria e Prostitucionit Diplomatik bëri përpjekje që i tërë votimi i diasporës të bëhet në përfaqësi diplomatike e që janë shndërruar në pika të LV-së, sipas “Urdhrit Ekzekutiv” të Albin Kurthit dhe Vojsa Osmanit, këta vendosën se kush duhet të jetë e kush nuk mund të jetë diplomat nga Kosova. Kriter ishte dëgjueshmëria ndaj Kurthit dhe Osmanit dhe trangu familjar jugosllav ose serb. Tash Sheriffe Osmani doli nga loja madje as sekseri Martin Berisha nuk i hapë telefonin. Këta organizuan votimin në përfaqësi diplomatike jo sipas rregullave të KQZ-së por sipas kodeksit të cubave partiakë. Martin Berisha, sekseri i GEN-it të Serbisë, i mbrojtur nga

Kurthi, Shvarci, Lenka Quko dhe Zhivadini i punëve të brendshme, i barte zarfet me fletëvotime sikur të ishin letër tualeti, për një përdorim përkatësisht për një numërim. Dhe dolën 82 për qind, sikur në kohën e Hoxhës, Titos, Çavezit apo Fidel Kastros. Hajni klasike! Tash, lehtësisht mund ta kuptoni pse me aq pasion, ligësi dhe poshtërsi duan të kapin Prokurorinë e Shtetit dhe Gjykatën Kushtetuese! Prokurorinë e Shtetit duan ta instrumentalizojnë për qëllime politike dhe kriminale; për të ndjekur hajnat e opozitës dhe kundërshtarëve politikë dhe, për të mbrojtur hajnat e pushtetit dhe të politikës aktuale. Përpara si sinonim i hajnisë merrej Ali Baba me 40 hajdutë kurse tani kemi Albin Babën me 4.....0 hajdutë. Gjykatën Kushtetuese duan ta kapin që t’i rrëzojë të gjitha ligjet e propozuara nga opozita dhe t’i përligjë të gjitha ligjet e pozitës. Kur e keni qëllimin e keq asnjëherë nuk realizohen të gjitha qëllimet. Nastradin Hoxha që botërisht njihet dhe pranohet si mashtruesi më i

madh në botë habitej me faktin se asnjëherë në mbrëmje nuk po i del siç e kishte planifikuar në mëngjes. Mësim për nastradinët tanë.

**Albini dhe pushteti:** Të gjithë ata që kanë menduar se Albini e lëshon me vullnet pushtetin, mund të binden se janë ndër lule duke marrë parasysh votimin në përfaqësitë diplomatike dhe konsullore, postën e shpejtë në bartjen e votave të sekserit Martin Berishaj, mendermethënë ambasador dhe sjelljet prej rrugaçësh të pushtetit në QNR-së. Salvador Alende, kryetari komunist i Çiles, pasi u rrethua në Pallatin Presidential “Moneda” nga forcat e Pinoçetit, në mbrojtje të karriges dhe pushtetit u vra duke luftuar me kallashnikov. Albin Kurthi nuk lufton sepse ashtu ka deklaruar më herët prandaj edhe nuk ka rrezik të vritet apo vdesë personalisht. Të tjerët mund të vriten apo vetëvriten për Liderin Suprem, aq iu vlen jeta! Albini nuk e lëshon asnjëherë pushtetin, nëse nuk detyrohet. Prandaj opozita duhet ta lë në

pushtet sepse në kohët që po vijnë kur askush nuk na pyet për asgjë, pushteti është rrethanë rënduese kurse mbetja në opozitë është shpëtim nga çdo përgjegjësi! E patë fatin e keq të Zelenskit, mezi doli i gjallë nga Shtëpia e Bardhë ndonëse ishte në të drejtën e tij. Me liderët tanë nuk mund të sillet ashtu, i ndjekim me Kanunin e Lekë Dukagjinit, fuck të drejtën ndërkombëtare. Mbështetur në këtë e keni reagimin e trojkës kryesore të mendimit politik dhe intelektual, prof. dr. Ramçes, Raskolnikovit të Prizrenit dhe Hysë Teneqes nga Klubi i Anarkistëve të Tiranës. Po mos të ishte reagimi i menjëhershëm dhe i guximshëm i kësaj trojke, kot do të mbahej Samiti i Shteteve të Evropës. E patë, Rute, Makron, von Lejen, Sholc dhe të tjerët këshillorin Zelenskin që sa më shpejt t’i kthehej Trampit, trojka e “mendimtarëve të pa tru” e ripostonin postimin e një adashi të tyre.: “Fuck... Mr. Trump...” Ajnshtajni thoshte se mençuria e ka një kufi kurse budallakia dhe injoranca jo. Të tillë jemi, rast sui generis!

## Mungesa e barnave esenciale, OFK: Vendimi për çmimin e barnave ka sjellë krizë në sektorin shëndetësor

**EPOKA E RE** Qendresa RAMA

**PRISHTINË, 3 MARS** - Oda e Farmacistëve e Kosovës ka shprehur shqetësimin lidhur me mungesën e barnave esenciale në sektorin publik dhe privat. OFK-ja përmes një ftese publike drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë ka kërkuar nga kjo e fundit të reflektojë mbi ruajtjen e shëndetit publik të qytetarëve. “Oda e Farmacistëve të Kosovës (OFK) shpreh shqetësimin e thellë lidhur me mungesën e barnave, përfshirë ato esenciale në sektorin publik dhe privat, që ka shkaktuar krizë në sistemin shëndetësor

dhe po cenon shërbimin cilësor shëndetësor të qytetarëve, krizë kjo që ka lindur si pasojë e vendimi të ministrit të Shëndetësisë për çmimin e barnave”, thuhet në njoftimin e OFK-së. Oda e Farmacistëve thekson se është duke pasur vazhdimisht presion nga anëtarët e saj dhe qytetarët për problemet që po hasen në mungesës të barnave esenciale, të cilat janë jetike për shëndetin e pacientëve dhe për funksionimin normal të sistemit shëndetësor. “OFK-ja me kohë ka paralajmëruar ministrin e Shëndetësisë shumë para nxjerrjes së vendimit se një metodë e tillë e punës do të shkaktojë këtë kaos në tregun farmaceutik duke cenuar edhe



sigurinë e qytetarëve tanë. OFK-ja konsideron se këto vetëm janë rezultatet e para të kësaj krize e cila vetëm sa do të vij e përkeqësohet”, thuhet më tej në njoftim. Oda e Farmacistëve e Kosovës i

ka bërë thirrje urgjente Ministrisë së Shëndetësisë që pas refuzimeve të përsëritura të ftesave të tyre për bashkëpunim, të vendosë interesin publik mbi interesat personale dhe të reflektojë për

këtë situatë të rëndë. “OFK-ja fton Ministrin e Shëndetësisë për hir të shëndetit të qytetarëve dhe për të shmangur përkeqësimin e mëtejshëm të situatës që të pezullojë menjëherë vendimin në fjalë në mënyrë që të zgjidhen këto probleme të cilat tashmë veç se janë hasur si pasojë e këtij vendimi duke siguruar kështu furnizimi të vazhdueshëm të tregut dhe qytetarëve me barna esenciale. OFK-ja, si çdoherë, siç ka shfaqur gatishmërinë e saj tash e 1 vit, është në gatishmëri 24 orë për ofrimin e zgjidhjeve MSh-së për eliminimin e këtyre problematikave profesionale”, thuhet në njoftim.

## A pritet të përfundojë këtë vit gjykimi i madh në Hagë?

PRISHTINË, 3 MARS - Fundi i këtij viti ose fillimi i 2026-s mund ta shënojë përfundimin e procesit gjyqësor ndaj ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të cilët Zyra e Prokurorit të Specializuar i akuzon për krime të pretenduara të luftës, vlerësojnë njohës të drejtësisë. Por, sipas tyre, është vështirë të jepet një afat kohor se kur mund ta marrë vendimin trupi gjyqësor, pasi thonë se kjo varet nga sasia e materialit provues.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi ndodhen në paraburgim në Hagë - qyteti holandez ku Gjykata Speciale e ka selinë që prej nëntorit të vitit 2020. Ndërkaq, gjykimi ndaj tyre ka nisur në prill të vitit 2023.

E deri në prill Zyra e Prokurorit të Specializuar pritet ta përfundojë dëgjimin e dëshmitarëve që i ka propozuar. Numri i dëshmitarëve të prokurorisë në atë që njihet si gjykimi i madh, ka mbërritur në 123.

Avokati i akredituar në Speciale, Artan Çerkini, thotë për KosovaPress se pas përfundimit të fazës së dëgjimit të dëshmitarëve të ZPS-së, avokatët mbrojtës të ish-krerëve të UÇK-së mund ta kërkojnë hedhjen e plotë apo të pjesëshme të akuzave.

Bazuar në këtë, ai beson se para muajit shtator mbrojtja nuk do të mund të fillojë dëgjimin e dëshmitarëve të saj. "Rasti i Prokurorisë mund të përfundojë më 4 prill, pastaj mbrojtja e ka një mundësi sipas rregullores së procedurës dhe



provave që të kërkojë që të hedhen poshtë të gjitha akuzat, apo të hedhen poshtë pjesërisht akuzat. Kjo do të thotë se nëse mbrojtja e vlerëson se Prokuroria përmes provave të prezantuara nuk e ka arritur standardin e provimit të fakteve përtej dyshimit të arsyeshëm, mbrojtja ka të drejtë që në këtë fazë të kërkojë nga gjykata që t'i hedhë poshtë akuzat. Ky është opsion i mbrojtjes. Nëse këtë e kërkon, natyrisht se kjo do të marrë kohë që gjykata të vendosë. Në të kundërtën, mbrojtja ka mundësi që të propozojë prova përmes të cilave synon t'i rrezojë provat e paraqitura nga Prokuroria, edhe ky opsion i mbrojtjes nuk është obligim... Kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës

gjyqësore do të varet edhe nga fakti nëse mbrojtja ka prova, sa ka mbrojtja prova, dhe në fund në bazë të procedurës edhe mbrojtja ka të drejtë që të administrojë prova", shprehet ai për KosovaPress.

Sipas avokatit, procesi gjyqësor, përfshirë edhe fjalën përfundimtare nga palët në rastin Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi, mund të përfundojë brenda këtij viti. Por, sipas tij, fundi i vitit 2025 nuk pritet të jetë edhe koha kur trupi gjyqësor do ta ketë vendimin përfundimtar për këtë rast. "Një prognozë optimiste është që rasti të përfundojë duke përfshirë edhe fjalën përfundimtare brenda këtij viti, ndërsa sa kohë do t'i duhen

gjykatës që të marrë vendim ajo varet edhe nga sasia e materialit provues që ka qenë në dispozicion në këtë çështje penale dhe ajo është vështirë të prognozohet në këtë fazë. Por, besoj që rasti si rast, duke përfshirë edhe fjalën përfundimtare të palëve, do të përfundojë brenda këtij viti", ka deklaruar Artan Çerkini për KosovaPress.

Edhe monitoruesja e Institutit të Kosovës për Drejtësi, Blendina Veliqi, thekson për KosovaPress se vjeshta mund të jetë si një afat kohor kur mund të përfundojë procesi gjyqësor ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi. Por, siç shprehet ajo, në rast të një vendimi, palët mund të

bëjnë ankesa edhe në shkallë të tjera gjyqësore. "Pas paraqitjes së provave të Prokurorisë, mbrojtësi i viktimave ka treguar se do të thërrasë dy deri katër dëshmitarë, që dy prej tyre mendohet se do të jenë ekspertë, kështu që pas fazës së paraqitjes së provave të Prokurorisë është paraqitja e provave nga ana e mbrojtësit të viktimave. Më pas do të fillohet me mocionet si nga ana e mbrojtjes, si nga ana e Prokurorisë, gjë që vjen puna deri në paraqitja e dëshmitarëve nga ana e mbrojtjes dhe ata kanë treguar se do të thërrasin disa dëshmitarë. Nuk mendohet se çështja të kryhet deri në shtator, tetor, të këtij viti. Çështja nuk do të përfundojë këtu për shkak se në rast të një vendimi, palët mund të bëjnë ankesa edhe në shkallë të tjera të gjykatës, kështu që procesi ndaj ish-krerëve të UÇK-së mund të vazhdojë tutje", ka theksuar Blendina Veliqi.

Një pjesë e madhe e këtij procesi gjyqësor ka kaluar në seanca të mbyllura për publikun dhe me dëshmitarë të mbrojtur, raporton KosovaPress.

Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi po përballesh me një proces të tejzgjatur gjyqësor. Ata ndodhen në paraburgim në Hagë që prej vitit 2020, ndërkaq gjykimi ndaj tyre ka nisur në prill të vitit 2023. Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi e Rexhep Selimi janë deklaruar të pafajshëm për të gjitha akuzat.

## Numërimi i votave nga diaspora, Abdixhiku: Nuk arritëm rezultatin e menduar, por jemi rritur

PRISHTINË, 3 MARS - Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se tani që numërimi i votave nga mërgata po i afrohet fundit, e kanë të qartë fotografinë finale të zgjedhjeve. Ai ka thënë se si LDK nuk e kanë arritur rezultatin e menduar, megjithatë thotë se kanë rritje të votës në zgjedhjet e 9 shkurtit. "Tani që numërimi i votave nga mërgata po i afrohet fundit, e kemi të qartë dhe fotografinë finale të zgjedhjeve tona. Jo, nuk arritëm rezultatin e menduar. Jo, nuk ndryshuam renditjen që dukej se na ishte parapercaktuar. Për këtë kam marrë përgjegjësinë mbi supë unë. Por, po, jemi rritur. Dhe atë për plot 70 mijë vota! Si kurrë më parë. Për plot 7 deputetë më shumë. Prandaj kokën lartë. Rënia, ajo katastrofalja, është e shpejtë! Shpeshherë dhe fatale. Ringritja, ajo e vështira, është e ngadaltë. Kërkon punë dhe punë shumë. Punë e shpresë

dhamë. Po bëhemi, sërish, adresë e 180 mijë qytetarëve tanë. Ecëm drejtë, ecëm mbarë. Mangu asgjë", ka shkruar Abdixhiku në "Facebook".

Ai ka thënë se do të sillen me plot dinjitet në gjithë rrugëtimin e tyre përpara. "LDK, si partia me rritjen më të madhe në këto zgjedhje, ka kthyer tashmë votuesin e vet. Koha të shkojmë përtej kësaj. Do të shkojmë. Dritë do të ketë. Faleminderit gjithë atyre që na besuat. Në veçanti,

faleminderit mërgatës sonë që na dhatë caq mbështetje. Asgjë befasuese. Së shpejti, pas certifikimit të rezultateve, do të nisi turneun e falënderimit. Sepse ju kam premtuar. Ju kam dhënë fjalën se nuk do të shihemi vetëm në zgjedhje. Do të takoj gjithë ata që u rreshtuan në thirrjen time për ndryshim. Këtë herë nuk ishim mjaft. Por u bëmë më shumë. Do të bëhemi dhe më shumë!", ka shkruar Abdixhiku.



## Në Aeroportin "Adem Jashari" sekuestrohen pako me cigare

PRISHTINË, 3 MARS - Policia e Kosovës ka njoftuar se më 2 mars rreth orës 11:00 në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës "Adem Jashari", si rezultat i bashkëpunimit ndërinstitucional, sigurimit të informacioneve nga zyrtarë doganorë dhe në bashkëpunim me stafin e X-Rey të aeroportit, në shkuarje për në Londër është ndaluar një femër e cila kishte në posedim një çantë krahu, të cilën dyshohej se e kishte të mbushur me pako të cigareve. E njëjta është kontrolluar nga zyrtarët e X-Rey në prani të

zyrtarëve kompetentë, ku në bazë të aparatit të kontrollit është detektuar se në çantën e krahu ka një sasi të konsiderueshme të pakove me cigare.

Udhëtarja femër, shtetase nga Shqipëria, dyshohej se, përpos çantës së krahu që kishte me vete, ajo në check-in në aeroport kishte dorëzuar edhe një valixhe në të cilën dyshohej se kishte pako me cigare.

Udhëtarja e ndaluar është dërguar në zyrën e doganës për t'i vazhduar procedurat e mëtejme, ku pas kontrollit

edhe të valixhes së dorëzuar në check-in, e njëjta ka rezultuar se ka pako me cigare.

Pas kontrollit janë sekuestruar gjithsej 4 boksa (shteka) cigare "Malboro e kaltër" dhe 20 boksa "Karelia Slims" me banderola të shtetit të Shqipërisë, të cilat ishin të padeklaruara në Doganën e Republikës së Kosovës. Pakot e cigareve janë sekuestruar dhe rasti i është dorëzuar Doganës së Kosovës për veprime të mëtejme sipas procedurave të parapara ligjore.



## Ish-ministri Çeku: Nuk mund t'i ikim shtrenjtimit të energjisë

PRISHTINË, 3 MARS - Ish-ministri i Energjisë, Ethem Çeku, në një intervistë për Radion Evropa e Lirë, konsideron se çmimi i energjisë elektrike do të rritet deri në 15 për qind.

Debati për rritje të mundshme të rrymës ka filluar pasi tri kompanitë energjetike në Kosovë, KEDS, KESCO dhe KOSTT, kanë kërkuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji ngritjen e çmimit të tarifave të energjisë elektrike për shkak të importit të energjisë elektrike. Në intervistën për REL-in, ai tha se për ta zvogëluar sasinë e importit, Kosova duhet ta rrisë prodhimin vendor, sidomos përmes energjisë alternative. "Realisht, Kosova po përballlet me mungesë të energjisë.

Dimrit, që jemi aktualisht, patëm mungesa të mëdha për furnizim të qytetarëve me energji elektrike. Kjo vjen si pasojë e mungesave të mëdha në investime, do të thotë nuk kemi ndërtuar kapacitete të reja energjetike. Ato të cilat janë ndërtuar, janë kryesisht solare dhe janë me kapacitete të vogla, janë të pamjaftueshme, edhe me erë ato që janë - janë të pamjaftueshme për ta furnizuar Kosovën në mënyrë të rregullt me energji elektrike", tha ai.

Çeku ka folur edhe për kërkesën e kompanive që të ketë rritje të çmimit të energjisë elektrike. "Unë besoj që zyra [ZRRE] duhet të



analizojë me kujdes, nuk duhet të pranojë rritje për 35 për qind, se është rritje shumë e madhe e energjisë elektrike. Qeveria duhet të ofrojë

subvencione, pra ndihmesë që të mos ngarkohet qytetari, megjithëse ato janë para të buxhetit. Po bëjmë një lojë, një sjellje atje. Unë besoj që nuk

duhet të kalojë mbi 15 për qind e rritjes së tarifave të energjisë. Zyra e Rregullatorit nuk duhet ta pranojë shifrën prej 35-përqindësh", tha ai. Por se a do të jetë rritja e domosdoshme, Çeku tha: "Normalisht, nuk mund t'i ikim. Nuk mund të ikin. Ky është koncept i gabuar që e kanë instaluar partitë politike. Qeveria aktuale që ka thënë se 'kur të vij unë në pushtet, kurrë s'e rriti (çmimin) e energjisë'. Në fushën e energjisë, të përmbysë revolucioni energjetik, nuk njeh qeverisje, se nuk varet prej teje, varet nga tregjet, nga bursat atje, në kohën e Covid-it, pastaj në vitin 2022 dhe 2023, arriti deri në 700 euro megavati".

## Rreth 8 milionë euro për 12 komuna përfituese

PRISHTINË, 3 MARS - Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal, Elbert Krasniqi, ka bërë me dije se me kryetarët e 12 komunave përfituese ka nënshkruar marrëveshjet për financimin e projekteve kapitale. "Kjo garë ka kuptim vetëm kur gara është transparente dhe se kjo garë tashmë ka rëndësi më të madhe pasi që është institucionalizuar dhe bazohet në ligjin përkatës të votuar në kuvend. Përmes këtij granti, MAPL dhe donatorët financojnë komunat në projekte të cilat kanë për qëllim zhvillimin ekonomik lokal,



gjithëpërfshirjen dhe digjitalizimin e shërbimeve komunale. Urime kryetarëve të komunave përfitues!", ka shkruar Krasniqi në "Facebook".

Kryetari i Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka thënë se buxheti i komunës së Drenasit do të shtohet për 1,263,557.36 euro, të cilat do të përdoren për projektet kapitale në dobi të qytetarëve kampionë të komunës kampion. "Është kjo hera e gjashtë që Komuna e Drenasit shpallet kampion dhe marrim buxhet shtesë për performancën e shkëlqyer, gjashtë herë të parët me

qeverisjen më të mirë, transparente dhe llogaridhënëse. Falënderoj donatorët, Agjencinë e Zvicrës për zhvillim dhe bashkëpunim (SDC), Abasadën e Suedisë, Fondet e Bashkimit Evropian dhe MAPL-në, ministrin Krasniqi, njëherësh, falënderoj qytetarët për bashkëpunim, zyrtarët komunalë dhe shefin e Ekipit të performancës, Afrim Prokshin. I lumtur që puna jonë vlerësohet dhe qytetarët tanë përfitojnë. Urime e përgëzime qytetarë të komunës së Drenasit vendi i parë dhe performanca e shkëlqyer. Vazhdojmë!", ka shkruar Lladrovci në "Facebook".

## Nga muaji prill Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë bëhet me hapësira të reja pune

PRISHTINË, 3 MARS - Nga muaji prill Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZhB) do ta ushtrojë veprimtarinë institucionale në pronën e Ministrisë së Bujqësisë në Ulpianë. Lajmin e ka dhënë

ministri i Bujqësisë, Faton Peci, në rrjetin social "Facebook".

Ai ka shkruar se kjo hapësirë e krijuar vetëm për Agjencinë, "është një nga kriteret e rëndësishme drejt

akreditimit të AZhB-së në fondet e Bashkimit Evropian". "Janë 1500 metra katrorë, me 30 zyra, salla takimesh e prezantimesh dhe hapësira të përshtatshme për arkivin që

tashmë janë rinovuar. Kjo hapësirë e krijuar vetëm për Agjencinë është një nga kriteret e rëndësishme drejt akreditimit të AZhB-së në fondet e Bashkimit Evropian", ka shkruar Peci.





# TAKIMI TRUMP-ZELENSKY: GJITHÇKA QË GAZETAT NUK E SHKRUAJTËN



Dihet nga të gjithë tashmë, se takimi Trump-Zelensky ka hyrë në histori. Po cili ishte ai moment, kur situata doli jashtë kontrollit të mirësjelljes apo të asaj që njihet si “politically correct”? Shumica e komentuesve e kanë analizuar ngjarjen duke e mbushur me tone viktimizimi dhe heroizmi. Në të gjithë Evropën, diskursi dominohet nga ideja e një Trump-i arrogant dhe një Zelensky të përulur dhe të turpëruar. Në rastin më të mirë, kemi të bëjmë me dembelizëm intelektual, në rastin më të keq, me dezinformim të qëllimshëm.

## Çfarë nxjerr në pah videoja origjinale?

Nga analiza e videos, dalin disa detaje që tregojnë një realitet ndryshe nga ai që është paraqitur dhe komentuar gjerësisht nga mediat ndërkombëtare. Ja disa vëzhgime kyçe: Nga biseda del e qartë se Zelensky ishte ftuar nga Trump për të diskutuar dhe firmosur një marrëveshje mbi mineralet e rralla dhe burime të tjera natyrore. Shtëpia e Bardhë

kishte organizuar një konferencë për shtyp përpara firmosjes së marrëveshjes. Trump ishte i sigurt për rezultatin. Ai e imagjinonte konferencën si një shfaqje të qeverisë amerikane që synonte të arrinte një marrëveshje, e cila do t'i jepte fund luftës. Në mendjen e tij, skenari do të përfundonte me firmat dhe deklaratat finale para kamerave. Zelensky nuk mund ta refuzonte ftesën, por ai nuk e kishte zgjedhjen për ta pranuar atë. Ndoshta i ndikuar nga Macron, Starmer dhe aleatët e tjerë evropianë, ai besonte se marrëveshja kishte të bënte vetëm me burimet natyrore dhe se ai mund ta përdorte këtë për të siguruar mbështetjen ushtarake të SHBA-së për luftën. Ai nuk e kuptoi se kjo marrëveshje ishte çelësi i negociatave të Trumpit me Putinin, për ta bindur këtë të fundit të bënte lëshime dhe për të siguruar që opinioni amerikan ta shihte çështjen e Ukrainës, vetëm si një çështje biznesi dhe interesash kombëtare, siç kishte thënë më parë Kissingeri: “Amerika nuk ka aleatë, ka vetëm interesa.” Ndërsa Trump jepte sinjale të

vazhdueshme se dëshironte të arrinte marrëveshjen, Zelensky e shfrytëzoi rastin për të ndikuar publikisht tek Trumpi, duke u përpjekur ta lidhte atë me strategjinë ukrainase për luftën. Ishte një truk i thjeshtë, por shumë i rrezikshëm, sepse synonte të sabotonte çdo bisedim midis Trumpit dhe Putinin. Pas dështimeve me Macronin dhe Starmerin, Zelensky ishte përgatitur të paraqitej si një lider i ashpër. Ai foli për 34 minuta rresht, duke përsëritur narrativën ukrainase të ndërtuar gjatë tre viteve të luftës, por nuk e kuptoi se ishte në një pozitë të pafavorshme, pasi Trumpi tashmë e kishte dekonstruktuar gjithë diskursin e administratës Biden mbi këtë konflikt. Gjatë monologut të Zelenskyt, Trumpi qëndroi në heshtje. Ai e pranoi faktin se marrëveshja e mëvonshme do të ndryshonte situatën, ndaj nuk reagoi ndaj fjalëve të tij. Zelensky e sfidoi hapur Trump-in, duke refuzuar çdo kompromis me Putinin dhe Rusinë, duke e quajtur atë një kriminel dhe terrorist. Ai kundërshtoi çdo armëpushim duke argumentuar se “Putini

nuk e respekton fjalën e tij”. Ai kërkoi garanci të reja ushtarake, përfshirë mbrojtje ajrore, trupa aleate në Ukrainë, më shumë armë dhe financime të pakufizuara për rindërtimin. Për 39 minuta, Trumpi u përpoq të përqendrohej tek marrëveshja, ndërsa Zelensky e përdori debatin për të forcuar pozicionin e tij luftarak. Në një moment, nënkryetari amerikan JD Vance nuk mundi të fshihte më sikletin e tij. Përplasja e vërtetë ndodhi në minutën e 40-të, kur Vance i bëri një pyetje të drejtpërdrejtë Zelenskyt: “A e pranoni se Ukraina po kalon një krizë serioze?”. Zelensky u përgjigj me një ton sfidues: “Të gjithë që janë në luftë kanë probleme, përfshirë ju. Por ju keni një oqean të tërë mes jush dhe luftës, kështu që nuk e ndjeni tani, por do ta ndjeni në të ardhmen. Falë Zotit, falë Zotit, falë Zotit.” Ky moment mund të interpretohej si kërcënim ose profeci, por Trump e ndërpreu menjëherë dhe i dha fund bisedës. “Ti nuk e di se çfarë do të ndjejmë,” i tha Trump. “Ne po përpiqemi të zgjidhim një problem. Mos na trego se çfarë

do të ndjejmë.” Në minutën e 46-të, Trump e përmbylli takimin, duke u thënë gazetarëve: “Mendoj se kemi parë mjaftueshëm për sot. Do të shohim si të gjejmë një zgjidhje.”

## Përfundimi

Përfundimi i këtij takimi ishte i qartë: Zelensky donte një samit për të imponuar vizionin e tij, por ai harroi se SHBA nuk mbron aleatët, por vetëm interesat e veta. Trumpi e kuptoi se Zelensky po përpiqej ta përdorte për të prishur negociatat e tij me Putinin, ndaj vendosi të shmangte deklaratat e forta dhe të mbyllte debatin. Për SHBA-në, çështja e Ukrainës nuk është një betejë për demokracinë, por një çështje biznesi dhe ekuilibrash strategjike.

## Për Evropën, ky takim është një alarm serioz:

Nëse SHBA-ja tërhiqet, Evropa do të përballet e vetme me pasojat e luftës. Nëse ndodh kjo, për SHBA-në do të jetë një fitore, por për Evropën, një makth i vërtetë. / [bota.al](http://bota.al)

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Reeves shpallet MVP i javës në Superligë

PRISHTINË, 3 MARS - Java e 22-të në ProCredit Superligën e Kosovës solli disa sfida interesante. Cory Reeves i Sigal Prishtinës ndaj Proton Cable Prizrenit e mbylli ndeshjen me 23 pikë, shtatë kërcime dhe dy asistime, duke u

shpallur MVP i javës së 22-të. Reeves kishte indeksin më të lartë nga basketbollistët e skuadrave fituese këtë xhiro. Trepça fitoi derbin e javës së 22-të ndaj Bashkimit, ku u dalluan Michael Green me 25 pikë, tri

kërcime dhe katër asistime dhe Drilon Hajrizi me 18 pikë, katër kërcime dhe katër asistime. Bora po vazhdon me formë të mirë në elitë, ku fitoi ndaj Golden Eagle Yllit në Therandë, derisa te prishtinasit u dallua

Dion Haxhosaj me 17 pikë, dhjetë kërcime dhe një asistim. Peja fitoi ndaj Vëllaznimit në një sfidë dramatike, ku te verdhezinjtë më i miri ishte Tulio Da Silva me 12 pikë dhe dhjetë kërcime.



## Kurti: Medalja e Donjeta Sadikut, e veçantë për Kosovën



PRISHTINË, 3 MARS - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se medalja e artë e fituar nga boksierja Donjeta Sadiku në turneun ndërkombëtar të boksit "Strandja" në Bullgari ka rëndësi të veçantë për Kosovën, pasi ajo është fituar pas 48 vitesh. Kurti ka shtuar se Donjeta Sadiku po e ndjek rrugën e legjendës Mehmet Bogujevci. "Donjeta Sadiku ka shkëlqyer në turneun ndërkombëtar të boksit 'Strandja 2025' në Sofje, duke

fituar medaljen e artë kundër boksieres nga Kazakistani me rezultat bindës 5:0. Gjatë rrugës drejt medaljes, Donjeta realizoi tri fitore, duke dëshmuar formën e saj të shkëlqyer dhe nivel të lartë të boksit. Njëherësh ajo mori titullin e një ndër boksieret më të mira të garës", ka thënë Kurti. "Turniri 'Strandja' është një nga turnirët më të vjetër të boksit amator dhe këtë vit shënon edicionin e 76. Kjo medalje ka

rëndësi të veçantë, ku pas 48 vitesh Donjeta bëhet boksierja e parë nga Kosova që e fiton të artën në këtë turne, duke ndjekur gjurmët e legjendës Mehmet Bogujevci i cili e fitoi të artën në vitin 1977. Në këtë garë medalje të bronzta fituan Loris Idrizi dhe Bashkim Bajoku, ndërsa referi ynë ndërkombëtar Latif Demolli po ndan drejtësinë në turne. Urime Donjetës dhe tërë ekipit tonë! Suksese në garat e radhës", ka shtuar Kurti.

## Kosova U17, e gatshme për ndeshjet e marsit në Qipro

PRISHTINË, 3 MARS - Përfaqësuesja U17 e Kosovës në konkurrencën e meshkujve ka nisur të hënën grumbullimin treditör në Kampin Nacional në Hajvali. Përzgjedhësi Arbnor Morina ka ftuar 20 futbollistë nga kampionati vendor dhe jashtë vendit, me të cilët ka zhvilluar stërvitjen e parë, derisa të mërkurën mbrëma do të udhëtojnë për në Qipro, për ndeshjet e raundit të dytë të

Ligës B në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian 2025. Morina për ndeshjet e marsit u ka dhënë përparësi disa futbollistëve të cilët nuk kanë qenë të pranishëm në ndeshjet kualifikuese të tetorit të kaluar të cilat u zhvilluan në Belgjikë. Disa futbollistë të grumbulluar kanë shqetësime me lëndime, mirëpo Morina shpreson që ekipi i tij ta japë më të mirën me

futbollistët e gjeneratës 2008, për të cilët këto janë ndeshjet e fundit para se ata ta ndryshojnë grupmoshën. Nga materialet e grumbulluara, trajneri Morina bashkë me stafin kanë analizuar edhe ekipet kundërshtarë me të cilat do të përballen. Se janë të motivuar për t'u kthyer me rezultate pozitive nga Qipro e ka thënë edhe futbollisti Omer Shala. E po aq pozitiv ishte edhe Besfort

Hoxha i cili zyrtarisht e përfaqëson Kosovën për herë të parë. Kosova ndodhet në Grupin e 4-të dhe për kundërshtar ka Andorrën, Qipron dhe Moldavinë.

### ORARI I NDESHJEVE:

Më 7 mars (11:00): Kosova U17 - Andorra U17  
Më 10 mars (11:00): Kosova U17 - Moldavia U17  
Më 13 mars (13:00): Qipro U17 - Kosova U17



## Khaka: Jam më në formë se kurrë, Alonso ka mentalitet kampioni



LEVERKUSEN, 3 MARS - Mesfushori shqiptar i Bayer Leverkusent, Granit Xhaka, pavarësisht moshës (tashmë 32-vjeçar), po bën një paraqitje të mirë me kampionët e Gjermanisë. Loja e tij në mesfushë e ka ngritur atë në lojtar kyç për Leverkusenin. Një gjendje fizike për t'u pasur zili nga Xhaka, të cilën e konfirmoi

për mediet. "Jam në formë. Ndoshta më në formë se vitin e kaluar. Sigurisht që nuk po bëhem më i ri por, me sa duket, nuk më duket dhe aq", ka thënë Xhaka. Duke folur për skuadrën, Xhaka ka shtuar: "Jemi ende shumë të qëndrueshëm, bëjmë presing lart, luajmë edhe një-një dhe

kjo më ndihmon". Pas ndeshjes, Xhaka e ka falënderuar edhe trajnerin Xabi Alonso: "Pasi shënojme gol ai vjen menjëherë te ne duke bërë titur më shumë, më shumë. Nuk dëshiron të ndalet kurrë. Një mentalitet i qartë për një trajner që nuk dëshiron t'i shohë kurrë lojtarët e tij të kënaqur". Megjithatë, përveç

ndikimit të trajnerit bask, lojtari ka thënë se ai u rrit duke parë lojën dhe qëndrimin e Toni Kroosit në fushë. "Sigurisht që ju shikoni lojtarët e mëdhenj për të parë se si e bëjnë këtë. Dhe unë jam një fans i madh i Toni Kroosit. Ai e bën shumë, ai tregon djathtas dhe më pas luan në të majtë", ka përfunduar Xhaka.

## Kosova në qershor zhvillon miqësore me Armeninë

PRISHTINË, 3 MARS - Federata e Futbollit e Kosovës ka aranzhuar një ndeshje miqësore me Armeninë e cila do të zhvillohet më 6 qershor në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Kjo përballje do

t'i shërbejë përzgjedhësit Franco Foda për ta testuar dhe përgatitur ekipin për ndeshjet kualifikuese të Kupës së Botës 2026 që do të nisnin në shtator, e ku Kosova bën pjesë në grup shumë të

fortë me Suedinë, Zvicrën dhe Slloveninë. Para kësaj miqësoreje, "dardanët" do të kenë dy sfida vendimtare gjatë këtij muaji ndaj Islandës në kuadër të "play-off"-it të Ligës së Kombeve, e

ku synojnë promovimin në Ligën B. Ndeshja e parë zhvillohet më 20 mars në orën 20:45 në stadiumin "Fadil Vokrri", e dyta më 23 mars në qytetin spanjoll Mursia.



## Testet në Bahrein shfaqën disa probleme të paparashikuara për Red Bullin

MANAMA, 3 MARS - Te Red Bullin nuk janë aspak të qetë pas testeve të Formula 1 të kryera javën e kaluar në Bahrein. Drejtori teknik i Red Bullit, Pierre Wache, nuk fshihet dhe flet për një RB21 problematik pas daljes së parë në pistë. "Nuk ishte një provë aq e qetë sa prisnim, por është më mirë të gjejmë disa probleme tani

gjatë testeve sesa më vonë. Ne u përpoqëm ta eksploronim potencialin e makinës dhe të kuptonim se si u përgjigjet strukturave të ndryshme dhe mendoj se pak a shumë ia dolëm", ka thënë Wache. "Mendoj se është shumë e vështirë për ta parë rendin startues për garën e parë në Melburn për

momentin. Mund të shihni se katër skuadra duken mjaft të shpejta, përfshirë ne, por nuk i kemi parë shumë ekipet e tjera, jemi përpjekur të fokusohemi në programin tonë", ka shtuar shefi i Red Bullit. Drejtuesi francez është i shqetësuar jo vetëm për problemet e besueshmërisë,

por edhe për llojin e zhvillimit që pret Red Bull më 2025: "Nuk jam aq i lumtur sa doja të isha sepse makina nuk u përgjigj ashtu siç donim në disa pika". "Gjithsesi, gjërat po shkojnë në drejtimin e duhur, thjesht ndoshta sasia e drejtimit nuk ishte aq e madhe sa prisnim dhe kjo është diçka për të cilën duhet të punojmë për garën e



parë dhe për zhvillimin e ardhshëm", ka shtuar Wache.

## Marquez, debutim ëndrrash me Ducatin në Tajlandë

BANGKOK, 3 MARS - Botërori i Moto GP-së ka nisur zyrtarisht sezonin 2025 me Çmimin e Madh të Tajlandës. Fundjava në Buriram pati epilog të njëjtë për sa i përket treshes së parë, duke nisur që nga kualifikueset, te Sprinti dhe te gara e madhe. Protagonist absolut ishte Marc Marquez, i cili e ka filluar në mënyrën më të mirë të mundshme aventurën e tij me Dukatin zyrtar. Pasi dominoi Sprintin, spanjollu u tregua i jashtëzakonshëm edhe në Çmimin e Madh. I nisur nga "pole position", Marc Marquez triumfoi pas një sfide emocionuese me vëllanë, Aleks. Gara ishte mjaft interesante, teksa Aleks, i ekipit Dukati Gresini, mori kreun dhe komandoi për shumë kohë. Por dy xhiro larg flamurit me kuadrate erdhi parakalimi vendimtar nga gjashtë herë kampioni i borës në klasën mbretërore të motorëve, duke hapur rrugë fitores në Tajlandë, ndërsa Marc Marquez u klasifikua në vendin e dytë. Një rezultat historik ky për Moto GP-në dhe familjen Marquez, me dy vëllezër që për herë të parë ndajnë podiumin. Vendi i tretë i



takoi pilotit tjetër të Dukatit zyrtar, Françesko Banjaja, ndërsa pokerin e markës italiane në Buriran e komplettoi Franko Morbideli i skuadrës VR46. Pas titullit në Moto 2, japonezi Ai Ogura shkëlqeu në daljen e tij të parë në kategorinë më të lartë, teksa japonezi i Aprilias (Trackhouse) u klasifikua në vendin e pestë, duke lënë pas italianin Marko Bexeki të Aprilias zyrtar. Garë e mirë edhe për Johan Zarkon, i cili e çoi Hondën (LRC) në pozicionin e shtatë, ku edhe në këtë rast kishim paraqitje më të mirë nga ekipi klient, në krahasim me atë zyrtar. Top 10 plotësohet sipas radhës nga Bred Binder (KTM) në vend të tetë, Enea Bastiani (Tech3) dhe Fabio Di Xhanantonio (VR46).

Provë negative për Pedro Akostën (KTM), i cili rrëshqiti në kthesën e parë të xhiros së tretë. Për sa i përket renditjes në përfundim të eventit të parë, Marquez ka marrë menjëherë rolin e liderit, duke kryesuar me pikë të plota, 37. Më pas, në vend të dytë ndodhet vëllai i tij, Aleks, në kuotën e 29 pikëve, ndërsa Peko Banjaja mbyll treshen e parë me bilancin e 23 pikëve nga eventit që hapi Botërorin 2025. Ndaleza e dytë sezonale e kampionatit do të jetë në një tjetër kontinent, teksa më 14-16 mars do të mbahet eventit i Argjentinës. Një tjetër etapë që premtos rivalitet, sidomos me dyshen e Dukatit, Marquez - Banjaja, pasi pritet me shumë interesim kundër-përgjigjja e pilotit italian.

### SHKURT

#### Presidenti i PSG-së: Fitimi i Ligës së Kampionëve nuk është detyrim

Nasser Al-Khelaifi, presidenti i PSG-së, ka thënë për "Bild" se fitimi i Ligës së Kampionëve nuk është më objektivi kryesor i klubit. "E pranoj hapur, ne po mësojmë nga gabimet tona. Nëse më pyesni nëse qëllimi ynë është ta fitojmë Ligën e Kampionëve, unë do të thosha jo. Por nëse më pyesni nëse duam të luftojmë në çdo ndeshje, përgjigjja është po. Ne duam të luajmë futboll sulmues, të argëtohem, absolutisht po. A kemi lojtarë për ta bërë këtë? Ende po. Ne kemi lojtarë që janë të aftë për të bërë një sezon të madh në Ligën e Kampionëve", ka thënë Al-Khelaifi.

#### Vinicius: Ndaj Athleticos dua një 'Bernabeu' të 'çmendur'

Sulmuesi i Realit të Madridit, Vinicius Junior, u ankua për lojën e dobët të skuadrës në humbjen kundër Real Betisit, në një mbremje në të cilën ai luajti takimin e tij numër 300 me skuadrën madrilene. Ai u fokusua në duelin evropian kundër Athleticos së Madridit, duke u kërkuar tifozëve madrilenë që ta kthejnë stadiumin "Bernabeu" në një ferr nesër në mbremje, në ndeshjen e parë të 1/8-ave në Ligën e Kampionëve. "Ajo në Seville ishte një humbje e shëmtuar për të gjithë, por kaq. Le të shpresojmë që e marta të jetë e 'çmendur' në 'Bernabeu'. Ne kemi nevojë për ju! Shihemi atje", ka shkruar Vinicius në rrjetet sociale "X", duke iu referuar tifozëve të Realit para ndeshjes kundër Athleticos në Champions.

#### Milani nuk planifikon ta shkarkojë Conceicao

AC Milan nuk ka plane për të shkarkuar trajnerin Sergio Conceicao pavarësisht prej formës së dobët të skuadrës, sipas burimeve të shumta në Itali. Kuqezinjtë kanë humbur tri ndeshje radhazi në Serinë A, përfshirë disfatën në shtëpi të së dielës ndaj Lazios, e cila i bëri ata të rrëshqasin në vendin e nëntë në tabelë. Megjithatë, pozicioni i Conceicao mbetet i pasigurt, dhe drejtuesit e klubit po ndjekin nga afër performancën e ekipit. Nëse rezultatet nuk përmirësohen, legjenda e Milanit, Mauro Tassotti, është duke u rreshtuar si një zëvendësues i mundshëm për ta marrë drejtimin deri në fund të sezonit. Tassotti, një ish-lojtar i Milanit dhe ish-asistent i Carlo Ancelottit, aktualisht po punon me ekipin e dytë të klubit, Milan Futuro, si asistent i Massimo Oddo. Njohja e tij me klubin dhe organizimin e tij e bën atë një opsion tërheqës për të qëndruar në anije nëse Conceicao përfundimisht lirohet nga detyrat e tij. Conceicao, i cili zëvendësoi Paulo Fonseca në dhjetor 2024, ka fituar tetë ndeshje nga 17, ka barazuar tre dhe ka humbur gjashtë. Kontrata e tij zgjat deri në vitin 2026, por klubi ka një opsion për ta ndërprerë marrëveshjen në fund të sezonit.

## Lakersat triumfojnë në derbin me clippersat

LOS ANXHELOS, 3 MARS - Fitorja e gjashtë radhazi për lakersat, që mundën me shifrat 108-102 clippersat në derbin e Los Anxhelosit, duke u ngjitur në vendin e dytë në Konferencën e Perëndimit. Doniqi me 29 pikë ishte shënuesi më i mirë për lakersat, ndërkohë që 36 pikë erdhën nga lojtarët e stollit, duke i bërë të pavlefshme 33 pikët e Leonardos. Clevelandi vijon të kryesojë si në Lindje ashtu dhe në renditjen e përgjithshme të NBA-s, duke fituar me shifrat 133-129 ndaj Portlandit. Gjashtë lojtarë të Cavaliersit realizuan mbi 12 pikë, ku u dallua Hunteri me 32 pikë. Zhgënjeu Miami, që në fushën e vet u mund me shifrat 165-112 nga New York, ku



protagonist ishte Jalen Brunsoni me 32 pikë. Skuadra kampione e Bostonit fitoi me shifrat 110-103 ndaj Denverit në një përballje rivalësh. Browni me 22 pikë e Hoprfordi me 19 u dalluan për Celticsin.

REZULTATET	
Boston - Denver	110-103
Cleveland - Portland	33-129
Indiana - Charlotte	127-112
Miami - New York	112-116
Orlando - Toronto	102-104
San Antonio - Oklahoma	132-146
Utah Jazz - New Orleans	121-128
Lakers - Clippers	108-102
Phoenix - Minnesota	98-116

Në krye të renditjes në Perëndim qëndron Oklahoma, që mundi me rezultat 146-132 San Antonion pas një ndeshje spektakolare. Jalen Williams e mbylli me 41 pikë, mbështetur nga Shai me 31 pikë.

## Dimarco humbet dy ndeshjet ndaj Feyenoordit

"Shqetësim muskolor në kofshën e djathtë". Ky është rezultati i testeve mjekësore që kreu Federico Dimarco, i cili u detyrua të largohej nga fusha

në ndeshjen ndaj Napolit për shkak të një kontraktimi në fleksorët e kofshës së djathtë. "Gjendja e tij do të vlerësohet në ditët në vijim", thuhet në

deklaratën e klubit zikaltër. Anësoni do të mungojë rreth 20 ditë, duke humbur ndeshjen e parë, ashtu edhe atë të kthimit kundër Feyenoordit në Ligën e

Kampionëve. Në kampin zikaltër shpresojnë ta rikthejnë ish-lojtarin e Veronës për sfidën ndaj Atalantës më 16 mars, por rikuperimi i tij

mbetet një sfidë e vështirë. Më i mundshëm duket rikthimi i tij pas pushimit ndërkombëtar (ndeshjeve të kombëtareve në mars).

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Vinlond" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811978040 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Vinlond" D.O.O. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811978040 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Vinlond" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811978040 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

## NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Eventaja" L.L.C. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811903641 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

## OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Eventaja" L.L.C. Pristina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811903641 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

## ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Eventaja" L.L.C. with headquarters Prishtinë, has come to the decision to quit its business: 811903641 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Kompania Regjionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë  
Me adresë: Rr. Xhem Sadrija pu, Fusha e Pejë - Tranzit KK Pejë

Bazuar në ligjin e Punës: LIGJI Nr. 03/L-212 sipas nenit 8, dhe në bazë të Udhzimit Administrativ MFPT- NR 01/2024, Kryeshefi Ekzekutiv i Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë me datë 04.03.2025, shpall konkurs të brendshëm për këtu vende të punës:

## KONKURS I BRENDSHËM

**Pozita:** Kontrollor i brendshëm (inspektor) - 1 pozitë

**Vendi punës:** Pejë  
**Kohëzgjatja e periudhës provuese është 6 muaj me mundësi vazhdimi sipas kontratave të ligjit të punës.**  
**Koeficienti i pagës:** 2.5

**Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:**

1. Obligohet që në terren të sillet korrekt dhe të mbaj uniformë dhe shenjë identifikimi të Ndërmarrjes;
2. Në baza ditore nxjerr nga CRM-ja ankesat që janë dërguar për inspektim, angazhohet drejtpërdrejt me rastin e zgjedhjes së ankesave dhe është përgjegjës për dhënien e shënimeve të duhura për zgjidhjen e këtyre kontesteve në afat sa më të shpejt;
3. Regjistron në CRM, të gjitha proqeset që i ka inspektuar sipas rregullores së punës;
4. Jep përgjegjësi për mos kryerjen e ankesave që i janë deleguar sipas CRM-së;
5. Sipas planit mujor të kontabilitetit bën inspektimin, monitorimin dhe rishikimin e aktiviteteve të inkasantëve në terren se a është bërë dorëzimi i faturave të konsumatorit dhe kontrollon se a janë të gjitha faturat në rregull;
6. Në bazë të kontrollimit të gjendjes reale dhe të të gjeturave në terren, raporton tek kontabiliteti me shkrim të protokolluar më numër personal dhe datë;
7. Raporton punën ditore, mujore dhe vjetore tek kontabiliteti;
8. Detyrohet të zbatojë disiplinën në punë, kodin e etikës, rregulloret / rregullat e caktuara nga ndërmarrja për këtë proces pune dhe në rast të shkeljes së tyre mban përgjegjësi disiplinore;
9. Kryen edhe punë të tjera operative me urdhëresë të kontabilitetit dhe ZKP-së;
10. Për mos respektimin e pikave të lartëcekura i përgjigjet drejtpërdrejt, Kryeshefit Ekzekutiv.

## a. Kushtet e përgjithshme:

- CV;
- Çertifikatë që kandidati nuk është nën hetime;
- Letër motivimi;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatë mbi gjendjen shëndetësore.

## b. Kushtet e veçanta (kualifikimet profesionale)

- Shkolla e Mesme, e preferuar Diplomë Universitare;
- Njohja e punës me kompjuter;
- Aftësia të mira komunikimi;
- 1 vit përvojë pune e dëshmuar;
- Ai /Ajo duhet të jenë në gjendje të punojë nën presion, të ketë moral të fortë për punë dhe integritet të nivelit të lartë.

**Mënyra e Aplikimit:** Dokumentacioni duhet të dërgohet në e-mailit [kruambientikonkurs@ gmail.com](mailto:kruambientikonkurs@ gmail.com)  
Data e për aplikim është nga 04.03.2025 deri me 19.03.2025 ora 12:00. Dokumentacioni që mbërrin pas afatit dhe i pakompletuar do të konsiderohet i pavlefshëm. Dokumentet origjinale mund të kërkohen, sipas nevojës. Vetëm kandidatët e selektuar për listën e ngushtë do të kontaktohen.

## &gt;&gt; SHPALLJE TË VOGLA &lt;&lt;

- Arianit Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Q.M.M. "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Qendra Rekreative "Pallma" B.I. nga Gjakova shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues 811608259 të lëshuar nga ARBK.

- Maurita Koca nga Bishtazhina KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

